



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-101

Prishtinë, më 20 prill 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 20 PRILL 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Petar Miletqi, Xhezair Murati dhe Numan Baliq;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e presidentit: Lumnije Murati;
Nga ICO: Blerta Bejtullahu dhe
Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dhjetë pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 prill 2010,
2. Propozimi për plotësimin e rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, që do të mbahet më 29 prill 2010, dhe
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 prill 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 prill 2010, u miratua me vërejtjen e Sabri Hamitit se nuk ishte evidencuar prania e tij në mbledhjen e 13 prillit 2010.

2. Propozimi për plotësimin e rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, që do të mbahet më 29 prill 2010

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që rendi i ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit të plotësohet edhe me pika të tjera.

Propozim-rendi i ditës për seancën plenare të Kuvendit, që do të mbahet më 29 dhe 30 prill 2010, është si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Propozim - Rregullores së Kuvendit,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mjekësinë ligjore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative,

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Metrologji,
11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2009,
12. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2009,
13. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2009,
14. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë kundër Korrupsionit, për vitin 2009,
15. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009,
16. Shqyrtimi i Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
17. Shqyrtimi i Propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës,
19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të nëpunësve në Agjencinë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar,
20. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, dhe
21. Propozimi i Grupit Parlamentar i LDD-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Njoftimi për dorëheqje z. Besim Beqaj nga pozita e kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK)

Kryesia, pasi u njoftua me dorëheqjen e kryesuesit të deritanishëm të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që në mbështetje të Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale, Kuvendit t’ia parashtojë propozimin për emërimin e kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.2 Miratimi i Udhëzuesit për elaborimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit vjetor të veprimit të Kuvendit për integritet evropiane

Kryesia miratoi Udhëzuesin për elaborimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit vjetor të veprimit të Kuvendit për integritet evropiane.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar për anëtarët e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në Shqipëri, nga 21-24 prill 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në këtë përbërje: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Radmila Vujoviq, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Bajram Kosumi dhe Adem Hajdaraj, si dhe i zyrtarëve të stafit mbështetës të Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi, në Kuvendin e Shqipërisë, prej 21 deri më 24 prill 2010.
2. Udhëtimi dhe mëditjet e plota përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me Rregulloren për udhëtime jashtë vendit.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar për anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, në Shqipëri, nga 26-28 prill 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, në këtë përbërje: Berim Ramosaj, Gjylnaze Syla, Ramadan Avdiu, Nait Hasani, Adem Hajdaraj, Rita Hajzeraj, Adem Salihaj dhe Zylfi Merxha, si dhe e zyrtares nga stafi mbështetës i Komisionit, Antigona Ibraj, në Kuvendin e Shqipërisë, prej 26 deri më 28 prill 2010.
2. Udhëtimi dhe mëditjet e plota përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me Rregulloren për udhëtime jashtë vendit.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar për anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian, në Bullgari, nga 26-29 prill 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian, në këtë përbërje: Zylfije Hundozi, Njomza Emini, Fatmir Rexhepi dhe Nait Hasani, në Bullgari, prej 26 deri më 29 prill 2010.
2. Shpenzimet e këtij udhëtimi për anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian i mbulon organizatori, -TAIEX, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë së Kuvendit nr.03-V-094.

3.6 Të ndryshme

3.6.1 **Ibrahim Makolli** ngriti çështjen e vlerësimit të mosefikasitetit të punës së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media dhe të kryesuesit të tij, për të cilin kryetari i Kuvendit ishte prononcuar për media.

Kryetari tha se edhe në seancë plenare ka pasur të njëjtën vërejtje dhe ka kërkuar nga të gjitha grupet parlamentare që të bisedojnë ose ta rifreskojmë këtë komision, ngase ka vonesa të mëdha në shqyrtimin dhe procedimin e projektligjeve.

3.6.2 Çështja e vonesës së shqyrtimit të projektligjeve

Në fund të mbledhjes u diskutua edhe për vonesën e shqyrtimit të projektligjeve nga shqyrtimi i parë deri në shqyrtimin e dytë.

U vlerësua se projektligjet po vonohen për shumë arsye, por më kryesore janë:

- Projektligjet e proceduara nga propozuesi - Qeveria nuk janë të hartuara mirë dhe duhet që me anë të amendamenteve të shumta të përmirësohet cilësia e tyre,
- Ndodh që për ndonjë projektligj të ketë ndërhyrje edhe jashtë trupave të Kuvendit, gjë që po ndikon në vonesën e procedimit të tyre.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në ora 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale